



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.1

Qershor 2024

GJUHA ANGLEZE NË FOKUS TË EVOLUIMIT TË POLITIKAVE ARSIMORE NË SHQIPËRI NË KONTEKSTIN DEMOGRAFIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Valbona Loshi

Fakulteti i Shkencave Shoqërore , Albanian University

Abstrakt

Reformat arsimore në Shqipëri, rreth vitit 2000, projektuan të mësuarit e gjuhës angleze si prioritet kombëtar dhe e drejtuan kurrikulën shkollore të gjuhëve të huaja në përputhje me nivelet e gjuhëve të dokumentuara në Kornizën e Përbashkët Evropiane e Referencës (CEFR), ndjekur nga vendimet e MASR për njohjen e testeve dhe diplomave të gjuhës angleze sipas standardeve ndërkombëtare të testeve të gjuhëve të huaja (2011; 2015), që u pasua me vendosjen e parakushteve për nivelet e gjuhës në shkollat nëntë-vjeçare dhe të mesme, niveli A1/A2 dhe B1/B2, (2012). Efekti më i fundit në ligjin parauniversitar ishte vendimi i Ministrisë së Arsimit për futjen me detyrim të lëndës së gjuhës angleze në kurrikulën parashkollore dhe gjithashtu shtimin e një gjuhe të huaj të dytë, përveç gjuhës angleze, që në klasën e parë të shkollës fillore (2020; Urdhër nr. 127/2021).

Bazuar në këtë kontekst, ky punim hulumton dy aspekte të mësimit të gjuhës angleze, rolin integruar dhe rolin funksional të përdorimit të saj, duke aplikuar dy mini teste nga instrumenti matës “Attitude Motivation Test Battery”, (Gardner R.C. 2011). Përzgjedhja e kampionit (N= 450) u krye mbi baza demografike, në pesë rrethe kryesore të vendit, përfshirë shkollat e mesme në zona urbane, rurale dhe shkollat jopublike. Ky studim zbuloi se rrethi i Vlorës (N=53), mbizotëron vlerat mesatare të të dhënave të përgjithshme të llogaritura në paketën statistikore për shkencat sociale ‘SPSS 22’. Orientimi i studentëve ndaj roleve të gjuhës angleze u mat me shkallë Likert, në intervalin e pergjigjeve sipas kodimit (1-6). Vlerat e moderuara më të larta, mbi (5) nga (6) gjithsej, rezultojnë tek nxënësit e shkollave të mesme publike në Vlorë, duke iu referuar mjedisit urban, për të dy variablat: rolin integruar dhe rolin instrumental të gjuhës angleze. Ky studim gjeti se subjektet nxënës të shkollave të mesme publike në qytetin e Vlorës janë të orientuar në formë të moderuar drejt rolit integruar dhe funksional të gjuhës. Përsa i përket zonave rurale, nxënësit e shkollave të mesme të rrethit Shkodër janë më të prirur ndaj mësimit të gjuhës angleze për shkak të rolit integruar të saj. Lidhur me shkollat jopublike, orientimi më i lartë i nxënësve ndaj këtij roli evidentohet në rrethin e Durrësit, (M=5,21) dhe të Korçës, (M=4,88).

Fjalë kyçe: *hartimi i politikave arsimore, roli instrumental i gjuhës angleze, roli integruar i gjuhës angleze, shkollat e mesme publike urbane dhe rurale, shkollat e mesme jopublike.*

ENGLISH LANGUAGE IN THE FOCUS OF THE EVOLUTION OF EDUCATION POLICIES IN ALBANIA IN THE DEMOGRAPHIC CONTEXT OF PRE-UNIVERSITY EDUCATION

Abstract

Very early reforms (2000), projecting English language learning as a national priority, would lead foreign languages school curriculum conform to language levels documented by Common European Framework of Reference (CEFR), followed by MASR Decisions for recognition of English tests and Certificates according to international foreign language test standards (2011; 2015) and by placing prerequisite language levels to be achieved in lower secondary and high schools A1/A2 and B1/B2 (2012). The most recent effect in pre-university law was the decision of Ministry of Education making English language obligatory for the preschool curriculum and the addition of a second foreign language, apart from English, since the first grade of elementary school (MASR Order no. 127/2021).

Based on this context, this paper investigates two aspects of learning English from integrative and functional perspective tested with two mini scales of the instrument "Attitude Motivation Test Battery", (Gardner, 2011). The instrument was applied on demographic basis, (N=450) in five main districts, including urban, rural, and nonpublic high schools in Albania. This research found that Vlora district (N=53), prevails in mean values of the overall data computed at SPSS 22. Students' orientation to English language roles, is measured with a Likert scale, at the range of 1-6. The highest mean values at above (5) out of total (6) stand for the public high school students in Vlora, referring to urban setting, for both variables the integrative role of language and instrumental role of English language. It can be stated that the subjects (N=53) public high school students in Vlora are moderately oriented to the integrative and functional role of the language. As far as rural areas are concerned, high school students in Shkodra district are more inclined towards learning the English language because of its integrative role, and in relation to non-public schools, the highest orientation of students towards this role is evident in the district of Durrës (M=5,21) and Korça, (M=4,88).

Key words: *education policy making, instrumental role, integrative role of English language, urban and rural public high schools, nonpublic high schools*

Hyrje

Në kuadrin e një politikëbërjeje evolucionare në arsimin shqiptar dhe në një epokë shumë promovuese sociale dhe politike drejt integritit evropian, është e nevojshme të bëhen kërkime për ndikimin që kjo shtysë ka, veçanërisht në sistemin arsimor parauniversitar. Për më shumë se një dekadë reforma të tilla arsimore kanë prekur ndjeshëm kurrikulën shkollore dhe së tepërmi mësimin e gjuhëve të huaja, veçanërisht atë të gjuhës angleze. Një objektiv shumë përforcues në sistemin shkollor dhe politikat arsimore në Shqipëri që u përmbush që në fazat e hershme të reformave arsimore (2000) është mësimi i gjuhëve të huaja në përputhje me nivelet gjuhësore të paraqitura nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencës (Common European Framework of References, CEFR). Një tjetër arritje u prezantua fillimisht në kontekstin shqiptar të arsimit parauniversitar mbi rritjen e ndërgjegjësimit për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të testeve të gjuhëve të huaja sipas Vendimeve të MASR për njohjen e testeve dhe certifikatave për nivelet ndërkombëtarishte të njohura të gjuhës angleze (MASR 2011; 2015). Plan programi i lëndës së gjuhës angleze ishte objekt i ndryshimeve të mëdha, duke pasur parasysh që gjuhës angleze iu dha përparësi që për herë të parë të bëhej pjesë e kurrikulës

së shkollës fillore, klasa e tretë (MASH, Miratimi i Programit të Lëndës Gjuhë Angleze, Cikli Fillor, CF, f.3, 2005).

Me Urdhër nr. 127/2021 të Ministrisë së Arsimit u miratua plan-programi për aktivitetet në “Institucionet e Arsimit Parauniversitar në Shqipëri”, ku përcaktohet se kurrikula e klasës së parë përmban nga dy orë gjuhë angleze dhe një orë mësimi të një gjuhe tjetër të huaj. Ky Urdhër erdhi pas një faze projekt pilot, i cili zgjati për gati dy vjet. Aktualisht mund të vlerësohet si një lidhje e qëndrueshme mes reformave për mësimin e gjuhës angleze dhe faktit se kjo gjuhë mbetet një prioritet kombëtar i optimizuar me standardet e vendosura prej dy dekadash tashmë, të cilat lidhen me një kurrikul të unifikuar të bazuar në libra të aksesueshëm me materiale praktike të shpërndara në shkollat në vend. Po ashtu, lind nevoja për një mjedis teknologjik më të përmirësuar për të mësuar anglisht, ndërgjegjësim për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të testeve të anglishtes dhe jo më pak e rëndësishme, një përgatitje për kulturën ndërkombëtare, e cila në ditët e sotme ndryshon shumë nga dy ose tre dekada më parë, për shkak të përdorimit të ngjeshur të mediave sociale dhe revolucionit në teknologji.

1. Këndvështrim teorik

Kërkimet empirike në fushën e motivimit dhe qëndrimeve ndaj mësimi të gjuhës së huaj janë mbështetur në instrumentin e përditësuar të testit origjinal nga Gardner R., Smythe P.C. (1974), i cili u mor nga Bateria e Testit Ndërkombëtar për Motivimin dhe Sjelljet ndaj mësimi të gjuhës së huaj¹ (Gardner, 2004, Attitude/Motivation Test Battery; International AMTB Research Project)². Testi i motivimit dhe sjelljeve ndaj mësimi të gjuhës së huaj është përdorur, si nga vetë hartuesit e Baterisë së Testit (Gardner R.C. et.al., 1975, 1985, 2001) në shtetin e Kanadasë e gjetkë, por edhe nga studiues të pavarur në disa shtete në botë si Japonia, Spanja, Polonia, duke iu afruar Ballkanit në shtete si Rumania dhe Kroacia. Për herë të parë, ky test është aplikuar në Shqipëri në vitin 2010 për 12 shkallët e tij. Më pas është ripërdorur në formatin e plotë, por të rindërtuar sipas ndarjes në pesë blloqe konceptuale ose variabla agregate. Një prej tyre është variabli i orientimit të gjuhës, i cili përbëhet nga dy komponentë: roli funksional i gjuhës dhe roli integruar i saj. Modeli Socioedukativ për mësimin e gjuhës së huaj është ndërtuar për nxënësit e shkollave të arsimit të mesëm, të ulët dhe të lartë, (Lower secondary or upper secondary), sipas sistemit shkollor kanadez, ku Robert C. Gardner dhe Wallace Lambert (1960), zhvilluan studimin origjinal mbi teorinë e motivimit dhe qëndrimeve në mësimin e gjuhës së dytë. Përvetësimi i gjuhëve të huaja, veçanërisht anglishtja, lehtëson procesin e integritetit të studentëve shqiptarë në këtë realitet, si dhe krijon bazën për prezantimin dhe ekspozimin e vlerave tona kombëtare në kulturën ndërkombëtare të njerëzve të ndryshëm në botë. Në dekadat e fundit, të gjithë janë të vetëdijshëm për rolin e madh që ka gjuha angleze në botë, veçanërisht për nevojat e komunikimit, kërkimit dhe komercializmit.

Në këtë studim, do të shqyrtohen konstruktet e modelit të përditësuar socioedukativ (Gardner R.C., 2001): orientimi integruar dhe orientimi funksional i gjuhës për të vlerësuar fuqinë e tyre në raport me variablin demografik (rrethet) dhe llojit të shkollës: e mesme publike në zonat urbane, e mesme publike në zonat rurale dhe e mesme jopublike.

1.1 Korniza ligjore e studimit

Gjuha angleze është konsideruar prioritet kombëtar në vendin tonë në dy dekadat e fundit, fakt që është paraparë në dokumenta strategjikë të Arsimit parauniversitar në vend, të tilla si:

➤ Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, SKAP, 2009-2013

1 Gardner R. C., Smythe P.C., (1974), Projekt kërkimor në gjuhësi në nivel kombëtar, shteti i Kanadasë, nga Universiteti i Ontarios Perëndimore, Departamenti i Psikologjisë, marrë nga: <http://publish.uwo.ca/~gardner/docs/caaltalk5final.pdf>

2 Gardner, R.C, 2004, Attitude/Motivation Test Battery: International AMTB Research Project, <http://publish.uwo.ca/~gardner/docs/englishamtb.pdf>

- Profili i Politikës Arsimore Gjuhësore, Shqipëri, Raporti i Shtetit, 2015-2017
- Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, SZHAPU, 2014-2020
- Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj


Duke qenë se në dekadat e fundit gjuha angleze është konsideruar prioritet kombëtar në vendin tonë (Strategjia kombëtare e arsimit parauniversitar, SKAP, 2009-2013) dhe lënda e gjuhës së huaj angleze u përcaktua të futet për herë të parë në provimet e përbashkëta të Maturës Shtetërore në vitin shkollor 2013-2014, (MASH, 2013, Udhëzimi Nr.46 për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë), si dhe u kthye në provim të detyrueshëm për pranimet në universitet³, (MAS, 2015), atëherë edhe Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar (SZHAPU), 2014-2020 i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MSA), parashtrohet Standarde Evropiane për mësimin e gjuhës angleze në kontekstin formal shkollor, ku synohet që, deri në fund të klasës XII, nxënësit të mësonin dy gjuhë të huaja dhe përvetësimi i gjuhës së parë të arrijë në nivelin B2, (MAS, 2015, SZHAPU, f.45). Shqipëria ka marrë pjesë në Vitin Evropian të Gjuhëve dhe ka zhvilluar portofolin e gjuhëve të huaja, i cili është publikuar nga Komisioni Evropian në Portalin e Politikave Gjuhësore të Këshillit të Evropës (Profili i Politikës Arsimore Gjuhësore, Shqipëri, Raporti i Shtetit, 2015-2017). Ky Raport synonte promovimin e një platforme ‘shumëgjuhëshe dhe edukimin ndërkulturor’ si edhe u përcaktua në dokumentin strategjik “Edukimi Plurilingual dhe Ndërkulturor”, ku është paraparë që gjuha angleze të konsiderohet si një gjuhë globale arsimit.

1.2 Roli funksional i gjuhës angleze

Modeli Socioedukativ i mësimin të gjuhës angleze, (Gardner R.C., 2001, 2005, 2006), përveç se investigon marrëdhënien e faktorëve socioedukativë me arritjet në gjuhë (notën përfundimtare), shqyrton gjithashtu marrëdhënien e këtyre faktorëve me motivimin, i cili është i vendosur në qendër të modelit (Figura 1). Gardner R.C. (1985), gjeti me anë të variantit të parë të modelit se të gjithë faktorët kishin lidhje me motivimin dhe faktori që kontribuonte më fort tek motivimi ishte ‘*roli i qëndrimeve ndaj kontekstit të mësimin të gjuhës së huaj*, më pas renditeshin *roli integruar i gjuhës* dhe *roli funksional i saj*, të cilët do të do të trajtohen në këtë studim. Indikatorët e rolit funksional të gjuhës janë: mundësi e avantuazhuar edukimi, punë dhe pagë më e mirë, rritje në detyrë, status më i lartë social-ekonomik.

1.3 Roli integruar i gjuhës angleze

Indikatorët e rolit integruar të gjuhës janë: lehtësia në ndërveprimin social me të huajt, optimizimi i ndjenjës së përkatësisë në grupimet ndërkombëtare, status më i lartë social, rritja e ndjenjës së vetë-besimit për shkak të përdorimit të gjuhës, njohja e kulturës dhe estilit të jetesës së vendit të origjinës të gjuhës.



3 Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS), Tiranë, 2015, Ligji Nr. 69/2012, dhe VKM, Nr.78, për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në universitet, i ndryshuar.

3. Metodologjia

3.1 Pyetjet kërkimore

1. Sa të ndikuar janë nxënësit nga roli funksional i gjuhës angleze për ta mësuar atë në shkollat e mesme publike në zonat urbane/rurale dhe private sipas shpërndarjes demografike në rrethet Korçë, Vlorë, Durrës, Shkodër, Tiranë?
2. Sa të ndikuar janë nxënësit nga roli integruar i gjuhës angleze për ta mësuar atë në shkollat e mesme publike në zonat urbane/rurale dhe private sipas shpërndarjes demografike në rrethet Korçë, Vlorë, Durrës, Shkodër, Tiranë?

3.2 Instrumenti

Instrumenti i përdorur në këtë studim është marrë nga Bateria e Testeve për Motivimin dhe Qëndrimet ndaj mësimi të gjuhëve të huaja, (Attitude Motivation Test Battery, AMTB, International Version, 2004). Dy shkallët e testit që u aplikuan në këtë studim janë:

- a) Roli integruar i gjuhës
- b) Roli funksional i gjuhës

Instrumenti është strukturuar sipas shkallës Likert, me 6 alternativa: Plotësisht jo dakord (1); Disi jo dakord (2); Paksa jo dakord (3); Paksa dakord (4); Disi Dakord (5); Plotësisht dakord (6). Në këtë shkallë nuk ka alternativë neutrale. Kodet nga 1-3 kanë vlera negative dhe tregojnë mospajtueshmëri me pohimet, ndërsa kodet nga 4-6 tregojnë vlera pozitive dhe reflektojnë pajtueshmëri në shkallë rritëse.

3.3 Besueshmëria e instrumentit

Koeficienti i përgjithshëm i besueshmërisë/konsistencës së dy shkallëve që u përdorën për të realizuar matjet (Roli integruar i gjuhës; Roli funksional i gjuhës) është 0,77, që tregon se testi është 77 % i qëndrueshëm për t'u përdorur (Brown et al., 2001, f. 264).

Tabela 1. Besueshmëria e instrumentit

Koeficienti Alpha Cronbach	Cronbach's Alpha i bazuar në artikujt e standartizuar	Numri i shkallëve
.777	.746	2

3.4 Variablat

Grupet e përfshirë në studim janë variabla të pavaruar nominalë:

1. shkollat e mesme publike në zona urbane
2. shkollat e mesme publike në zona rurale
3. shkollat e mesme jopublike.

Varibla kategorikë - ordinalë të cilët maten me shkallën Likert.

1. Roli integruar i gjuhës
2. Roli funksional i gjuhës


3.5 Kampioni i studimit

Kuadri i kampionit në këtë studim janë shkollat e mesme të përgjithshme, publike dhe jopublike në zonat urbane dhe rurale të rretheve: Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Korçë. Popullata e studimit është $N = 47165$ nxënës dhe përzgjedhja e kampionit ($N = 450$) u krye me anë të metodës së përzgjedhje rastësore, 'Random sampling' nga lista e klasave 10 -12, duke aplikuar teknikën "Rao Soft Sampling Size" për të nxjerë kampionin nga popullata totale e nxënësve mbi baza demografike të pesë rretheve. Përzgjedhja e kampionit sipas rretheve është: Korçë $N=44$, 9.78%; Vlorë $N = 53$, 11.83%; Durrës= 73 , 16.17%; Shkodër $N=64$, 14.22%; Tiranë $N=216$, 48%.

Tabela 2. Statistikë përshkruese për shpërndarjen e kampionit sipas shpërndarjes demografike

	Rrethi	Frekuenca	Përqindje	Përqindje e vlefshme	Përqindje e akumuluar
E vlefshme	Korçë	44	9.78	9.78	9.78
	Vlorë	53	11.83	11.8	21.6
	Durrës	73	16.17	16.17	37.8
	Shkodër	64	14.22	14.22	52.0
	Tiranë	216	48.0	48.0	100.0
	Total	450	100.0	100.0	

Figurë 2. Pamje grafike e shpërndarjes në përqindje të kampionit të studimit



3.6 Analiza e të dhënave.

Të dhënat në këtë studim për $N=450$ subjekte, u përpunuan nëpërmjet SPSS 22 për të zbuluar vlerën mesatare dhe devijimin standart të variablave të pavarur sipas shpërndarjes demografike në rrethet Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Korçë dhe sipas llojit të shkollës: e mesme publike në zonat urbane, e mesme publike në zonat rurale dhe e mesme private.


4.Rezultatet

4.1 Roli integrues i gjuhës

Tabela 3 pasqyron vlerat e mesatares dhe devijimit standart për variablin “roli integrues i gjuhës angleze”. Rezultoni nga analiza e të dhënave se vlera më e lartë mesatare për rolin integrues të gjuhës është për nxënësit në shkollat publike në qytetin Vlorës ($M=5.21$) dhe Durrësit ($M=4.79$). Ndërsa vlera më e ulët rezultoi për nxënësit në shkollat publike të qytetit të Korçës ($M=3.96$). Përsa i përket vlerave të rolit integrues të gjuhës angleze për nxënësit në shkollat e mesme në zonat rurale rezultoi se vlera më e lartë mesatare është për nxënësit në shkollat publike në qytetin e Shkodrës ($M=5.23$) dhe Durrësit ($M=5$), ndërsa vlera më e ulët rezultoi për nxënësit në shkollat publike të qytetit të Korçës ($M=3.16$). Përsa i përket shkollave private vlerat më të larta mesatare janë njëlloj të barabarta për nxënësit e qytetit të Korçës ($M=5.2$) dhe Durrësit ($M=5.2$), ndërsa vlerat më të ulëta mesatare për variablin e rolit integrues për nxënësit e shkollave private qëndrojnë për qytetin e Tiranës ($M=4.39$).

Tabela 3. Të dhënat përshkruese të vlerave të mesatares dhe devijimit standart për rolin integrues të gjuhës angleze sipas llojit të shkollës dhe shpërndarjes demografike

		Shkollë e mesme në qytet				Shkollë e mesme në fshat				Shkollë e mesme private	
N		Mesatare	D.Standard			Mesatare	D.Standard			Mesatare	D.Standard
44	Korçë	3.96	1.03		Korçë	3.16	1.27		Korçë	5.2	1.23
53	Vlorë	5.21	1.08		Vlorë	4.77	1.31		Vlorë	4.8	1.13
73	Durrës	4.79	1.03		Durrës	5	0.79		Durrës	5.2	0.87
64	Shkodër	4.8	1.08		Shkodër	5.23	0.77		Shkodër	4.68	1.08
216	Tiranë	4.23	1.16		Tiranë	4.50	1.46		Tiranë	4.39	1.39



Figurë 3. Pamje grafike e rolit integrues të gjuhës angleze sipas shpërndarjes demografike dhe llojit të shkollës


4.2 Roli funksional i gjuhës

Tabela 4 pasqyron vlerat e mesatares dhe devijimit standart për variablin “roli funksional i gjuhës angleze”. Nga analiza e të dhënave përshkruese, vlera më e lartë mesatare për rolin funksional të gjuhës rezulton për nxënësit në shkollat publike në qytetin e Vlorës ($M=5.2$) ndërsa vlera më e ulët rezulton për nxënësit në shkollat publike të qytetit të Korçës ($M=3.7$). Përsa i përket vlerave të rolit funksional të gjuhës angleze për nxënësit në shkollat e mesme në zonat rurale rezulton se vlera më e lartë mesatare është për nxënësit në shkollat publike në rrethin e Shkodrës ($M=4.9$) vlera më e ulët rezulton për nxënësit në shkollat publike të rrethit të Korçës ($M=3.1$). Përsa i përket shkollave private vlerat më të larta mesatare janë për nxënësit e qytetit të Durrësit ($M=4.8$), ndërsa vlerat më të ulëta mesatare për nxënësit e shkollave private qëndrojnë për qytetin e Korçës ($M=4.6$).

Tabela 4. Të dhënat përshkruese të vlerave të mesatares dhe devijimit standart për rolin integruar të gjuhës angleze sipas llojit të shkollës dhe shpërndarjes demografike

Roli funksional i gjuhës së huaj									
	Shkollë e mesme publike në qytet			Shkollë e mesme publike në fshat			Shkollë e mesme jopublike		N
	Mesatare	D.Standard		Mesatare	D.Standard		Mesatare	D.Standard	
Korçë	3.7	1	Korçë	3.1	0.5	Korçë	4.6	1.2	44
Vlorë	5.2	0.9	Vlorë	4.4	1.1	Vlorë	4.4	1.1	53
Durrës	4.4	0.9	Durrës	4.4	0.9	Durrës	4.8	0.9	73
Shkodër	4.5	1.1	Shkodër	4.9	0.6	Shkodër	4.4	1.1	64
Tiranë	4.2	1	Tiranë	4.2	1.3	Tiranë	4	1.2	216

Figurë 4. Pamje grafike e rolit funksional të gjuhës angleze sipas shpërndarjes demografiek dhe llojit të shkollës



5. Diskutime

Përsa i përket linjëzimit të gjetjeve në këtë studim në nxënës të shkollave të mesme në Shqipëri, janë më të prirur ta mësojnë gjuhën e huaj për shkak të rolit funksional të saj, kjo gjetje evidentohet edhe në studime të tjera në rajon. Nikolaou, (2007) zbuloi në kërkimin e tij se nxënës të shkollave të mesme greke kishin prirje të larta për të dy tipet e orientimeve të gjuhës së huaj, por ishin dukshëm më të orientuar drejt aspektit instrumental të gjuhës se sa ndaj aspektit integrues të saj. Gjithashtu, Nikolov (2001), provoi se nxënës të Hungari konsiderojnë gjuhën angleze si gjuhë të huaj më e dobishme, për shkak se është një mjet komunikimi ndërkombëtar dhe vetëm një numër i vogël i pjesëmarrësve në studim e konsideronin kulturën e gjuhës angleze si tërheqëse. Edhe studime të tjera në botë kanë provuar se orientimi instrumental i gjuhës është më i fuqishëm se ai integrues, Zahra, V. (2008), Iran; Le Le Huong Hoa (2013), Vietnam; Rehman A. Bilal A. (2014). Rezultatet në këtë studim shkojnë në të njëjtën linjë me Le Le Huong Hoa (2013), Vietnam; Zahra, V. (2008), Iran; Rehman A., et.al (2014), Pakistan, të cilët zbuluan se nxënës ishin më shumë të orientuar ndaj funksionalitetit që ofron gjuhë se ndaj rolit integrativ të saj dhe se rezultatet për të dy rolet e gjuhës reflektoheshin në një nivel të moderuar.

Tipikisht për studimet e kryera nga vetë autori i Attitude Motivation Test Battery (ATMB) dhe kolegët e tij, Gliskma, Gardner dhe Smythe (1982), është zbuluar se nxënës, të cilët ishin kryesisht të motivuar nga pikëpamja integrative për të mësuar gjuhën, tregonin më shumë devotshmëri dhe ishin më të aktivizuar në orën e anglishtes, jepnin përgjigje më të sakta, ishin më të kënaqurit nga mësimi në fund të seancës. Kërkimet empirike të mëvonshme të Gardner R.C., et.al. (1985, 2001, 2005), vlerësuan rolin integrues të gjuhës së huaj në Modelin Socioedukativ si komponenti social-kulturor, që mbizotëron rolin instrumental të gjuhës në lidhje me motivimin për të mësuar gjuhën e huaj. Referuar gjetjeve në këtë studim shprehen tendencat e ndryshuara të nxënësve shqiptarë drejt orientimit funksional të gjuhës angleze, krahasuar me rezultatet në vitin 2011 në Shqipëri, ku Softa V., zbuloi se prirja e nxënësve orientohej më së tepërmi drejt rolit integrues të gjuhës, gjetje kjo që përkonte me linjën e studimeve empirike të autorit të Testit të Motivimit dhe të Qëndrimeve, Gardner dhe Schimdt (1981), Gliskma, Gardner dhe Smythe (1982), Gardner R.C. (2001, 2005, 2009). Pra, si edhe vërehet nga rezultatet e studimeve, roli integrues i gjuhës ka qenë domethënës dhe i qëndrueshëm për tre dekada në kërkimet empirike (1981, 2001, 2009). Ndërsa provohet se orientimi drejt rolit funksional të gjuhës është fuqizuar pas vitit 2010, ku studimet treguan se orientimi integrues i gjuhës angleze u zëvendësua me orientimin funksional të saj, mund të thuhet se kjo gjetje shkon në linjë me situatën social-ekonomike në Evropë dhe në vendin tonë, ku gjuhë e huaj shërben me rolin funksional të saj në avantazhimin e mirëqenies për një status më të lartë ekonomik, duke bërë që ky rol të rezultojë më i ndjeshëm krahasuar me atë integrues, në një kontekst ku integrueshmëria e Shqipërisë në komunitetin e evropian ka gjetur një stabilitet të konsiderueshëm krahasuar me një dekadë më parë.

6. Përfundime

Roli integrues i gjuhës së huaj në këtë studim u shpreh me anë të tre shkallëve: interesi për gjuhën e huaj, qëndrimet ndaj të huajve, orientimi integrues i gjuhës së huaj, nga të cilat rezultoi se në përgjithësi, nxënës të shkollave të mesme në vend (N=450) në rrethet Tiranë, Durrës, Korçë, Shkodër dhe Vlorë shfaqin interes për gjuhën e huaj, por në nivel të moderuar, si dhe mbajnë qëndrime pozitive ndaj të huajve që flasin gjuhën angleze, në nivel të ulët. Ky studim zbuloi se në përgjithësi nxënës shqiptarë që ndjekin shkollat e mesme në Shqipëri janë më të prirur të mësojnë gjuhën angleze për rolin funksional të gjuhës së huaj në raport me rolin integrues të saj.

Nxënës shqiptarë në rang kombëtar kanë prirje në nivel të moderuar, (M=4.44), për t'u orientuar drejt rolit funksional të përdorimit të gjuhës, pasi procesi i mësimi të gjuhës lidhet me perceptimet e nxënësve se gjuhë e huaj angleze ndikon pozitivisht në të ardhmen e tyre, në disa aspekte si: përmirësimi i standardeve të jetesës, pagë më e mirë, rritje në detyrë, suksesi në karrierë. Përsa

i përket orientimit integruar ata vlerësojnë si të rëndësishme njohjen me të huajt që flasin gjuhën angleze si gjuhë amtare, familjarizimin me kulturën dhe stilin e jetesës së tyre, aftësinë dhe lirinë në të shprehur me të huajt.

Ky studim zbuloi se në përgjithësi nxënësit e shkollave të mesme në Vlorë mbizotërojnë me vlerat e moderuara më të larta krahasuar me rrethet e tjera. Po ashtu, nxënësit e rrethit të Vlorës në kategorinë e shkollave të mesme urbane rezultojnë me vlerat mbi (5) nga totali (6), për të dy variablat: rolin integruar dhe rolin instrumental të gjuhës angleze. Pra nxënësit në shkollat e mesme publike, Vlorë janë më tepër të orientuar drejt mësimi të gjuhës angleze për arsye të rolit integruar dhe funksional të gjuhës angleze. Përsa i përket zonave rurale, nxënësit e shkollave të mesme të rrethit Shkodër janë më të prirur ndaj mësimi të gjuhës angleze për shkak të rolit integruar të saj dhe funksional të saj. Ndërsa, në lidhje me shkollat private, orientimi më i lartë i nxënësve ndaj rolit integruar dhe funksional evidentohet në rrethin e Durrësit dhe të Korçës. Nxënësit në kryeqytet, në tre tipet e shkollave, kanë treguar interes jo të lartë ndaj mësimi të gjuhës angleze për shkak të orientimit integruar dhe funksional të saj, duke u përqëndruar në vlerën e mesatares ($M=4$).

Si përfundim, ky studim gjeti se nxënësit shqiptarë në shkollat e mesme, ($N=450$) aktualisht kanë orientim më të fortë drejt mësimi të gjuhës angleze për shkak të rolit instrumental të saj, krahasuar me tendencën për rolin integruar që ishte më i ndjeshëm për këtë popullatë në dekadën e kaluar.

Referenca

1. Abdol L. Fadzil, L. Bahroom R., Mohamad W. (2011), *Global Learn Asia Pacific 2011 - Global Conference on Learning and Technology*, The role of motivation, eprints.oum.edu.my/565/1/role_motivation.pdf, tërhequr më dt. 3.04.2014
2. Alatis, J., Altman, H., and Alatis, P. (1981). *The Second Language Classroom: Directions for the 1980's*. Neë York: Oxford University Press.
3. Baker & Macintyre, (2000), Language acquisition and motivation, f. 318 (cituar tek Hashimoto Y., f. 31, Motivation and Willingness to Communicate as Predictors of L2 Use, *Second Language Studies*, 2002)
4. Bernaus, M.& Gardner, R. C. (2008). Teacher motivation strategies, student perceptions, student motivation, and English achievement. *Modern Language Journal*, 92, 387-401. Cited at Gardner R. C., 2005, *Integrative motivation and second language acquisition*, p.10
5. Brown J.D., (1996), *Testing in language programs*. Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall Regents, f. 192, cited at Hashimoto Y., 2002, P. 45. *Second Language Studies*, 20(2), Spring 2002, pp. 29-70 Crookes, G.& Schmidt, R.W.(1991). Motivation: reopening the research agenda. *Language Learning*, 41, 469-512, cit. tek Dörnyei Zoltan, (1998), *Motivation in second and foreign language learning*, f. 122, *Language Teaching*, 31, pp 117-135, doi:10.1017/S026144480001315X, withdrawn 10.02.2023
6. Davis, J.A. (1971). *Elementary survey analysis*. Englewood Cliffs, NJ: Prentice Hall.
7. Desrochers A., Gardner R.C., (1981), Second language acquisition : an investigation of bicultural excursion experience, Quebec: International Center of research for bilingualism, Laval university cituar tek Gardner 1985, *Social psychology and second language learning: The role of attitudes and motivation*, P.116
8. Dörnyei Z. (1990). Conceptualizing motivation in foreign-language learning. *Language Learning* 40: 45-78. Cit. tek Alexander Nikolaou (2007), Attitudes and motivation of Greek secondary pupils toward learning English, : <http://www.enl.auth.gr/gala/14th/Papers/English%20papers/Nikolaou.pdf>
9. Dörnyei Z. (1998). *Motivation in second and foreign language learning*. *Language Teaching*, 31, pp 117-135, doi:10.1017/S026144480001315X Gardner Robert C., (2005). *Integrative*



**SHKENCAT
E
APLIKUARA
DHE
EKONOMIKE**

SEKSIONI 3

